



VENDIM

Nr. 176, Datë 07.07.2022

MBI

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 144, DATË 06.06.2022 “MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 415, SERIA P18K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “BLAC ENERGY” SH.P.K. ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 157, DATË 09.07.2018”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 95 dhe nenit 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; nenit 7, 8 dhe 9 të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.07.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 965/1 prot., datë 30.06.2022, të përgatitur nga grupi i punës “Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 144, datë 06.06.2022 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria p18k, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “BLAC ENERGY” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 157, datë 09.07.2018”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 144, datë 06.06.2022, vendosi të fillojë procedurën për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 157, datë 09.07.2018.
- Ky vendim u mor për arsye se shoqëria “Blac Energy” sh.p.k., nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2021 për licencën në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike e po ashtu nuk kishte depozituar në ERE asnjë dokument apo argument në lidhje me mos zbatimin e këtij detyrimi.
- Me shkresën nr. 515/1 prot., datë 10.06.2022, shoqëria është njoftuar për vendimmarrjen si më sipër, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.

- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare (statement) të ERE-s rezulton se kjo DEBI është shlyer më datë 20.06.2022.
- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar për dijeni të subjektit, rezulton se shoqëria i ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit dhe nuk është më debitore ndaj ERE-s.
- Në nenin 8 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, parashikohet se *Pas marrjes së përgjigjes më shkrim nga i licencuari sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentat e paraqitur dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari, dhe do t'i propozojnë Bordit. a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës në rast se i licencuari dëshmon mungesën e kushteve të përcaktuara në pikat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe/ose “d” të nenit 5 të kësaj rregulloreje.*
- Në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: *Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.*
- Dispozitat e nenit 95 zbatohen për çdo procedurë administrative pavarësisht nëse është filluar kryesisht nga organi publik ose me kërkesë të palës. Në këtë rast “qëllimi” i procedurës, lidhet ngushtësisht me marrjen e masave administrative kryesisht nga organi që ka kompetencën, me qëllim shmangien e faktorit që ka nxitur vendimmarrjen. Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të dispozitës së mësipërme, është bërë i pamundur për shkak të ndryshimit të rrethanave faktike dhe shlyerjes në masën 100% të vlerës së debisë nga shoqëria “Blac Energy” sh.p.k.
- Vërtetimi i shlyerjes së pagesës së prapambetur, fakton ndryshimin e statusit të subjektit të cilit i kundrejtohet masa administrative, duke rezultuar në rënien e shkakut që çoi në marrjen e masës për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.
- Në nenin 9, gërma “a” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, parashikohet se: *Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Përfundimin e procedurës administrative të filluar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 144, datë 06.06.2022 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për

veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Blac Energy “ sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 157, datë 09.07.2018”.

2. Shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 144, datë 06.06.2022 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 415, seria P18K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “Blac Energy” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 157, datë 09.07.2018”.
1. Grupi i Punës të njoftojë shoqërinë “Blac Energy” sh.p.k për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s,- brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Petrit AHMETI**